



[Lajme](#)
[Sport](#)
[Showbiz](#)
[Tech](#)
[Indeks](#)
[Opinione](#)
[Ekonomi](#)
[Shëndetësi](#)
[TV Tip](#)
[Kërko](#)

Ndodheni

Indeksonline / Lajme

11:30 / E hënë, 12 Nëntor 2012

50 Komente

Maxhuni: Policia nuk ndikohet nga politika



Foto: Shpend Maxhuni

Nga: Valdrin Krasniqi

Ndonëse kanë kaluar tri javë nga protesta e Lëvizjes Vetëvendosje, e mbajtur në Prishtinë kundër takimit të kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij serb Ilica Daciç, në opinion ende përmendet sjellja e protestuesve dhe reagimi i Policisë.

Gjatë protestës kishte dhunë, sprej arrestime e lëndime. Komisioni për Punë të Brendshme në Kuvendin e Kosovës, menjëherë kishte kërkuar

raport nga ministri i brendshëm, Bajram Rexhepi dhe Drejtori i Policisë, Shpend Maxhuni. Ky i fundit e ka kryer një obligim të tillë dhe për Indeksonline tregon se si është sjellë policia ditën e protestës.

"Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri në Kuvendin e Kosovës ka kërkuar një raport sa i përket rastit që ju e përmendët dhe i njëjti është përcjell Komisionit në afatin e paraparë në bazë të kërkesës së parashtruar", ka deklaruar Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni.

Duke folur për protestën e Lëvizjes Vetëvendosje, kreu i policisë kosovare thotë se, Policia e Kosovës pas secilit operacion policor e bënë analizën dhe vlerësimet post operacionale në terren.

"Natyrsh, në rast të konstatimit të tejkalimit të përdorimit të forcës për raste individuale, rastet si të tilla i referohen për trajtim mekanizmeve përkatës, prandaj ju bëjmë me dije se është vepruar konform Ligjit dhe rregulloreve në fuqi", ka deklaruar për Indeksonline Maxhuni.

Policia e Kosovës, sipas tij, veprimet e saja i ka ndërmarr konform autorizimeve ligjore që ka dhe në asnjë mënyrë nuk ka përdorur dhunë, por si rrjedhojë e veprimeve të dhunshme nga ana e protestuesve është detyrues të përdoren forca e parashtrura dhe pajisjet policore për

Të tjera

Tribunali do të hetoi Del Ponten nëse kërkon Prishtina e Tirana

Maqedonasit do ta rrisin natalitetin me femra ruse

Çitaku: Kosova po përmbush kriteret e KE-së

Tanke para pallatit presidencial në Kajro

Konjufca: Grabovci na shau nënën

Mbi 300 të vrarë nga tajfuni në Filipine

Recommendations

Klani "Sekiraça", kryen plagosje për hakmarrje (VIDEO)
90 people recommended this.



Të fundit

Më të lexuara Më të komentuar



11:38 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
Tribunali do të hetoi Del Ponten nëse kërkon Prishtina e Tirana



11:33 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
Google Play iu mundëson bizneseve që të mbajnë aplikacionet e tyre



11:28 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
Maqedonasit do ta rrisin natalitetin me femra ruse



11:17 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
Çitaku: Kosova po përmbush kriteret e KE-së



11:05 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
"Kosova e Re", dështon edhe sivjet



11:03 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
Edhe qentë mund të mësojnë drejtimin e veturës



11:00 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
Domatja, efekti çudibërës në humor



11:00 / E enjte, 06 Dhjetor 2012
"Divorci më ka shkatërruar totalisht"

veprimet e personit i cili e njoftojmë dhe pajisjet policore për shpërndarje të turmës së dhunshme, pajisje këto të autorizuar me ligj.

Ai tha se atë ditë protestuesit kanë pas në duar të tyre kubëza të gurit dhe njëkohësisht disa prej protestuesve kanë qenë të dhunshëm ndaj policëve. Si rezultat i veprimeve të tilla, në bazë të raporteve që posedojmë, një numër i zyrtarëve policor kanë qenë të lënduar si pasojë e gjuajtjes me gurë nga protestuesit. E kemi edhe një rast kur zyrtarit të Policisë së Kosovës i'u është thyer edhe dora nga dhuna e ushtruar nga protestuesit.

Vetëvendosja e akuzon Policinë e Kosovës së është e politizuar dhe merr urdhra nga njerëz të politikës.

Mirëpo Shpend Maxhuni nuk mendon ashtu. Ai thotë se, Kushtetuta e vendit si dhe Ligji i Policisë së Kosovës i qartësojnë raportet lidhur me përgjegjësitë dhe obligimet që ka secili institucion.

"Policia e Kosovës është institucion i zbatimit të ligjit, i cili zbaton politikat e sigurisë të hartuara nga Qeveria e vendit dhe në këtë drejtim, Policia e Kosovës do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në përmbushjen e misionit dhe vizionit të saj dhe objektivat e përcaktuara", thotë Drejtori i Policisë së Kosovës, Maxhuni.

Punën e Policisë së Kosovës, sipas Maxhunit, e mbikëqyrin mekanizmat përgjegjës të pavarur ligjorë siç janë: Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Komisioni Parlamentar për Siguri, dhe këto praktika janë shembulli më i mirë i një mbikëqyrje demokratike dhe institucionale, ashtu siç funksionojnë praktika të ngjashme edhe në shtetet me traditë dhe përvojë të gjatë në demokraci.

Raport para Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në Kuvendin e Kosovës, për protestën e Vetëvendosjes, përveç Maxhunit është obliguar të japë edhe Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi. Ky i fundit, e ka

kryer obligimin, mirëpo komisioni ka kërkuar një raport me të detajuar./Indeksonline/



Priten edhe kater drunj në shesh

5 people recommended this.



Digjen veturat e Qeverisë

Valdrin Krasniqi and 127 others recommended this.



Kryeministri gjendet në WC

Durim M. Hajdini and 345 others recommended this.

Facebook social plugin

Like 5 Shpërndaje 5 Tweet 1 0

Kendi i komenteve

roki 12.11.2012 / 23:41

Pse bre po rren Enver....

Kartushi 12.11.2012 / 22:30

Policia e Kosoves eshte instrument i Hashim Thacit dhe xharrahit Bajram Rexhepit .Polici katastrofe, mjere populli kush eshte duke e mbrojtur ligjin atje.Fund.

Gdg 12.11.2012 / 18:42

Policia si milicis

Ademi në Gjermani 12.11.2012 / 18:10

@hops- për këtë duhet të jesh i afërt me polici dhe të evitohen parregullsit në të gjitha instucionet për këtë edhe vetë policia po punon natë e ditë sikurse që e zbuloi vjedhjen në Pejë.Populli duhet të jetë dora e djathtë e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Agroni 12.11.2012 / 18:05

Luje mac kryt e bullit luje

Agimi 12.11.2012 / 18:03

Jam me LDK dhe nuk kam pasë respekt ndaj PDK, e tash personalisht kam respekt ndaj Thaqit i cili ka guxim dhe aftësi që të hynë në dialog,pra u treguan të guximshe edhe partitë e tjera.Sa për Policin e Republikës së Kosovës kjo me përpikëri i ka zbatue ligjet, pa marrë parasyshë se cila parti është në pushtet Policia vepron ngjashëm.

Vedati 12.11.2012 / 17:56

Unë vllaun e kam në VV por vetë vllaun distancohet nga veprimet që i shkaktoi VV ndaj policisë së Kosovës,Policia është e jona dhe nuk ka

komente,kush eshte kunder policise se popullit te vet ai eshte eane
kuner Zotit dhe shtetit te vetë.

hops 12.11.2012 / 17:52

PER ADEMIN NGA GJERMANIA KU E SHEF TI ATE POLICI MODERNE
NE KOSOVE KUR U VODHE DHOMA E DESHMIVE NGA VETE POLICIA
VETM LEXONI KOMENTIN E ISH-POLICES-VIOLETES E KUPTON
KUSHE E UDHEHEQ KET P.K

arturi 12.11.2012 / 17:47

Po pse bre po rren pash tmadhin zot,po krejt politik je mbrenda.

Ademi në Gjermani 12.11.2012 / 17:41

Hashimi ulm- po ti je një qyqar, e nuk guxon me tregue të vërteten se të
kthejnë në Kosovë si plehin,une jam me emer të vërtet e ti je një qyqar i
shkretë,tregoma adresen unë vijë aty nëse ma dergon një vizë oj qyqe
Email:adembi@hotmail.com

hajni_pr 12.11.2012 / 17:40

patriot eshte edhe ai qe rren si ti. pa ftye ishit. SHIK-u i kujt eshte? bla-
bla-bla.....

gipa 12.11.2012 / 17:39

sa qesharak eshte shpendi kur dihet se me jogurt revolucionin eshte
ardh ne pozite hahahahahahahah

fati 12.11.2012 / 17:39

PO KY ASHT UDBASH EDHE I BIRI UDBASHIT

KastriotSHIKu 12.11.2012 / 17:38

PK udhehiqet nga PDK, shtyllat kryesore jane te perzgjedhurit ne fillim
nga Rexhep Selimi e me vone nga SHIKu, ish sindikata e milicve jane
servil te SHIKut

ADEMI 12.11.2012 / 17:28

Per Luftetarin si genjen po nuk esht as pak evertet se qka thua ti ti
spaske qen kurr un shtetin gjermon veq paske degjue per ta a sa
knaqen rinia po shifet 59 % papunsia rugve po shifet sa po knaqet
rinia un Kosov

agrioni 12.11.2012 / 17:27

te kishim besu , sigur te mos i shohim gjerat ne teren qdo dite, sikur qe
ndodh me njesit e mbrojtjes se afer kur njeri nga policet qe eshte ne
mbrojtje te presidentes merr gucimin te kercenoi anetarin e KQZ ,
dhepas suspendimit per njikohe te shkurt ai eshte kthyer ne sherbim te
presidentes, fal intervenimit pikerisht nga politika zoti drejtor PK

Hashimi ulm 12.11.2012 / 17:16

per Ademin un Gjermani si ste vjen turp me genjuy se sjeton vetum ti
un gjermani ka si plot bile me shumic qe thojn te verteten mos genje or
kodosh

NAFTETERI 12.11.2012 / 17:12

PSE PO GENJEN MORE BURR QYSH SPOTE VJEN TURP EDHE
FEMIA 1 VJEQ E DIN KET PUN TURP TE KESH

ANTI pdky 12.11.2012 / 16:38

Po ti MILIC I hashimit ... PO MENODON QE POPULLI HAN BARI ??!!

Kastrati 12.11.2012 / 16:05

Më vjen shumë keq që armiku po ma keqpërdor mbiemrin por nuk

besojë se është shqiptar-KastriotSHIKu, ky mundet me qenë shka ose
bashkpuntor i shkieve,se njeriu që jeton në Republikën e Kosovës ai e
qmon vleren e Presidentit, të kryeministrit dhe institucionet tjera të
republikës së Kosovës, se na po shofim mirë se qka po bonë serbia
dhe si po i shfrytvzon disa shqiptarë si bashkpuntor,e tërë këtë po e
zbulon policia e Republikës së Kosovës, ne nuk kemi lindë pas
shpalljes së Pavarsisë por disa kanë lindë në ish jugosllavi dhe kanë
punuar në institucione të Kosovës e mu disa komentues që tash e kanë
ndrruar shpiunllakun kanë qenë bashkpuntor të shkinisë sikurse që
dihet lista e bashkpuntorëve që shpiunuan në shërbimin ushtarak të
ish jugosllavisë e të gjithë këta bashkpuntor me profesione të
ndryshme.Policia është e Popullit dhe do të ndihmojmë deri në
maksimum.

Ademi në Gjermani 12.11.2012 / 15:48

Kemi një polici moderne shikoni rastin e 25 Korrikut që tash po realizohet ai akcion, shikoni se si vepruan policia në rastin e Vidovdanit - pra polici me të gjitha të mirat, veq qorrat dhe shpiunat folin keq për Polici dhe shtetin e vetë. Unë jetojë qe disa vite në Gjermani dhe kurr asnjë gjerman nuk e kritikon shtetin e vet, ju e dini mirë dy gjermanit i bashkoi AMERIKA edhe ende i ka trupat e veta Amerika në Gjermani.

Bedri 12.11.2012 / 15:41

Plotësisht i përkarahe sjelljet e Policisë së Republikës së Kosovës. Vetë sjelljet e demonstruesve nuk kanë qenë korrekte, ofendojnë policinë sikurse ajo të ishte e okupatorit shekullor, marri për disa komentues që dëshirojnë Kosovën ta shofin në anarki.

Luftëtari 12.11.2012 / 15:36

Unë jetojë dhe punojë në Republikën e Kosovës, kam punuar në Gjermani dhe në Francë mos mendoni se atje është parajsë. Ata që jetojnë në perendim e din se si gjykohe, e din se si denohet dhe po ju tregojë se një shok i imi pa fajin e tij vetëm se u mbrojtë nga fjalët e këqia të gjermanit, gjykata e ka denue me 5000€. Gëzohuni Rini dhe Pleqëri që e krijuam shtetin tonë.

gyrbetqari 12.11.2012 / 15:36

Jo qe nuk ndikohet nga politika po esht endar ne III ne PDK, AAK, dhe LDK, kota tri parti e humbin imashin e Policis e te gjith shtetit per intersa grupe.....

Emini 12.11.2012 / 15:30

Si në cdo vend të Evropës dhe të botës policia e zbaton ligjin dhe i mbron të mirat materiale dhe njerzore. Rrofshi Polici dhe Institucionet e Republikës së Kosovës deri në Bashkimin Kombëtar me të gjitha trojet shqiptare.

Besi 12.11.2012 / 15:15

Policia e Republikës së Kosovës u krijua nga njerëzit më të mirë dhe kombëtar që kontribuan dhe jetën e tyre e sakrifikuan për këtë vend. E disa filmena kërkusha që marrin social në shtetet e perendimit dhe janë vegël e shikeve i pengon shumë policia e Republikës së Kosovës.

hajt pake 12.11.2012 / 15:13

SHPEND MAGJUNI THOTE Policia e Kosoves eshte institucioni i zbatimit te ligjit, i cili zbaton politikat e sigurise te hartuara nga qeveria e vendit ketu mbete te dihet nga udheheqet P.K

KastriotSHIKu 12.11.2012 / 15:09

pse po rren o rrenc e i biri i rrencit, po shume mire dihet se si je pranue polici, ti dhe prindi juaj, prindi juaj argat i SHIKut, lojen e flitit ne fillim mir u shit te SHIKu se e ka shfrytezu deri sa ka punesu familjar e te njohshem per interesa te PDK, analisti prindi juaj i ka diskualifiku kuadrat profesioniste me ndihmen e SHIKut te mos jene pjestar te PK, ne anen e kundert jane pranue kriminel e paramilitar, te gjitha keto dallavere i dine shume mire Atifete Jahjaga, presidentja nuk e ka pas veshtir te kerkoj kete post qe ka, nese pak shtrengohet presidentja komplet duhet te shkarkohet udheheqesia e PK, lendet qe jane te policeve te diskriminuar qendrojn te bllokuara.

Dosti 12.11.2012 / 14:56

Eeeh HUMORISTI vogel.

Shqypitar 12.11.2012 / 14:50

100% e sakte ajo qe e thoni sepse SHPK eshte vet politika dhe s'keni nevojte te ndikoheni prej askujt, jeni vet SHIK-u, UDB-ja, e çdogje tjetere, veç n'sherbim t'popullit shqiptar t'Kosoves s'jeni!

KapetanLleshi 12.11.2012 / 14:43

Ky eshte i biri i UDB-ashit te serbise, edhe vet u kan UDB-ash, dhe tash eshte i SHIK-ut. Dihet se UDB-ja dhe SHIK-u jane njejt, dhe keta kanqene gjith bashke.

qytetar 12.11.2012 / 14:36

Vallai edhe ju disa komentues veq po ja futni kot, nuk eshte e veretete qe politika perzihet ne Polici, ka raste por ato jan shume te rralla. Per mendim timin policia ne protesten e VW, ka vepru drejt dhe ka zbatu ligjin e nese ka pas naj individ qe ka perdor dhun te tepruar ather ai duhet te hetohet e jo krejt policia se vallai te mire jan shumica e

policise, kaq kisha une.

Arbnor 12.11.2012 / 14:23

Ke te drejt,nuk ndikohet nga politika,por nga krimi i organizuar dhe nga SHIK.

sereti 12.11.2012 / 13:48

hashimi ju derixhon kate don ju as gojen zguxoni me qel prej Diktatorit komunist hashim rexhep hajredin kuqi

ish-Police-Violeta 12.11.2012 / 13:43

Njesia per luftimin e korrupcionit jane komplet nen kontrollin e LATIF GASHIT, ata i versulen sipas direktivave te LATES. Kjo eshte me se e vertet dhe askush nuk mund te ndihet i sigurt me ne Kosove, as individet e as bizneset. Pra njeriu i dyle i SHIK-ut kontrollon krejt policin, hetuesit per luftimin e krimit ekonomik dhe taskforces antikorruption. Sa do te shkoj kjo let te shkon, vetem let ta din as EU, dhe USA jane shume mire te informuar per njerezit qe LATIF GASHI i ka vendos ne keto njesi, ata dihen kush jane. Ata hetues ne keto njesi jane shume ta pasur, kane biznese te mshefta. Grahin BACALOK grahni

hajt pak 12.11.2012 / 13:39

Mos genjej, nga politika jo,e nga Shik-u pra e keta njerze jane ne politike!!!!!!! dhe nese jo ,pse e hiqen Behar Selimi se dojke me i qele do dosje qe njerezit e Politikes ishin aty

hajt pak 12.11.2012 / 13:34

Mos genjej, nga politika jo,e nga Shik-u pra e keta njerze jane ne politike!!!!!!!

selim 12.11.2012 / 13:28

EX KPS 12.11.2012 / 12:36 Jo qe vetem udhëhiqet nga politika por direkt udhëhiqet nga SHIK. Të gjithë udhëheqësit e njësive me te rendsishme ne shtyllen e Hetuesis jan antar te SHIK-ut dhe hetuesit poashtu, sidomos ne Departmentin Antidrogë, antikorruption, Trafikim qenjesh njerzore Inteligjencë, Kontraband mallrash, etj. Mos me thuani jo sepse si ish pjes e tyre jam shum mir i njoftuar me keto sene. Per ket arsye edhe jemi ku jemi. A i ke te identifikuar me emer e mbiemer qe kur ti vie koha duhet ti qojm te shpija,kurgja ma shume.

MarigonaX 12.11.2012 / 13:15

Vertet! Nuk ndikohet nga politika por nga SHIK-u???!!!!

Bedriu 12.11.2012 / 12:36

Shpend ti veq tregona sa here te thirre hashimi ne telefon brenda dites

EX KPS 12.11.2012 / 12:36

Jo qe vetem udhëhiqet nga politika por direkt udhëhiqet nga SHIK. Të gjithë udhëheqësit e njësive me te rendsishme ne shtyllen e Hetuesis jan antar te SHIK-ut dhe hetuesit poashtu, sidomos ne Departmentin Antidrogë, antikorruption, Trafikim qenjesh njerzore Inteligjencë, Kontraband mallrash, etj. Mos me thuani jo sepse si ish pjes e tyre jam shum mir i njoftuar me keto sene. Per ket arsye edhe jemi ku jemi.

Gre 12.11.2012 / 12:34

Inrwrvnemi i policise ate dite u kon korrekt, por protestuesit kane qene te dhunshem

Aeroplani 12.11.2012 / 12:18

MozAllah.

Mentori 12.11.2012 / 12:07

Nuk edi si po kerkoni llogari nga agjenti i SHIK-ut. Ky eshte ne sherbim te SHIK-ut o Burra. Vetum qe me mledh deshmi mundesh me ja mar naj deklarate qe kur te behete shteti ligjor me fut krejt keta hajna ne burg. Ska nevoj per analiz. Ku del Bajram Rexhepi dhe jep Urdher sikur Bekiri tek Filmi i Mehmet Kosoves, qe ju jepke urdher Bandes se vet. Ky Bajram HAJMALIN nuk e konsideron sikur Politikan por sikur udheqes se bandes se ti. Per kete arsye ky thot politika nuk u perfshi ne polici.

teli 12.11.2012 / 11:55

nuk e di perse flasin keta njerez keshtu kur jan xhirimet ku shifet

kryepolici Gerguri duke e godute me shqelam personin e shtrire pertoke e te lidhur, tye gjitha org per te drejtat e njeriut si dhe amnesty

internatona kan deklarue se ka pas anune policore , si eshte e mundur qe keta kaq lirshem deklarojne gjera te tilla thuase ne te gjith jemi injorant deri ne ate mase sa qe as filmat e marre nga ngjarje nuk dijm te shikojme. kjo eshte marra e radhe sne policine tone.

Shpendi 12.11.2012 / 11:53

Fjala jote ne vesh te zotit o Gjeneral I Policise.

Mendimi 12.11.2012 / 11:44

E vertete eshte kjo qe e thote Maxhuni

Besa 12.11.2012 / 11:42

Policia mes dy zjarreve. Me intervenu zor, mos me intervenu i larkojne prej pune

redoni 12.11.2012 / 11:42

PO ai qe dha urdher te largohen protestuesit per 1 min nga vjen zMaxhuni ? edhe thua se nuk ka ndikim !!

seferi 12.11.2012 / 11:33

Inshalla osht qysh po thue.

Emri:

Komenti:

Sqarim:

Ndalohen fyerjet dhe përdorimi i gjuhës ofenduese. Indeksonline mban të drejtën e publikimit ose jo të një komenti të caktuar. Përmbajtja e komenteve nuk pasqyron, qëndrim editorial të redaksisë së portalit Indeksonline.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

[Ballina](#) [Lajme](#) [Sport](#) [Showbiz](#) [Tech](#) [Indeks+](#) [Opinione](#) [Ekonomi](#) [Shëndetësi](#) [TV TIP](#) [Lojëra](#)

Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët - Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

© 2010-2012 Portali Indeksonline.

E Enjte, 06 Dhjetor 2012

Indeksonline sh.p.k

Tel.: 049 / 732 - 732

E-mail: info@indiksonline.net
marketing@indiksonline.net

Dizajni dhe zhvillimi: Kreatoda